

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Ekonomisë dhe Financave / Ministarstvo Privrede i Financija
 Ministry of Economy and Finance
 Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova - Tax Administration of Kosovo
 Arhiva / Arhive

Njësi: Org. Org. Org.
 Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.
 09-06-971

Data Datum Date:
 11.06.2010

PRISHTINË/A



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. Dep. Dep. Dep.
 2-0

Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.
 01-2336/10

Data Datum Date:
 11.06.2010

PRISHTINË

REPUBLICA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
 PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA
 KOSOVA TAX ADMINISTRATION

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NË MES TË

AGJENCISË KUNDËR KORRUPSIONIT DHE
 ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi pajtohen si në vijim

1. Agjencia kundër Korrupsionit dhe Administrata Tatimore e Kosovës krijojnë raporte të partneritetit dhe bashkëpunimit në parandalimin, luftimin e korrupsionit dhe ekonomisë joformale përmes:
 - a) Shkëmbimit të informacioneve lidhur me korrupsionin dhe fshehjen e tatimit;
 - b) Bashkëpunimin në hetimin e rasteve që rezultojnë me veprime kriminale të korrupsionit dhe fshehjes së tatimit;
 - c) Ndhimën dhe asistencën teknike të ndërsjellë në proceset hetimore;
 - d) Ofrimin e këshillave të ndërsjella në realizimin e bashkëpunimit nga fushat respektive.
2. Agjencia kundër Korrupsionit do t'i ofrojë ndihmë Administratës Tatimore të Kosovës në rastet kur posedon informacione për personat fizik dhe juridik të cilët i shmangen

tatimit si dhe ofrimin e informacioneve në rast të falsifikimit të dokumentacionit me qëllim të fshehjes së tatimit.

3. Administrata Tatimore e Kosovës do t'i ofrojë ndihmë Agjencisë kundër Korrupsionit në proceset e iniciuara hetimore nga sfera e natyrës së korrupsionit përmes dhënies së informatave, ndihmës teknike dhe formave të tjera konform ligjeve në fuqi.
4. Administrata Tatimore e Kosovës më kërkesën e Agjencisë kundër Korrupsionit do ti ofrojë Agjencisë informacione në lidhje me të hyrat e deklaruar vjetore të personave fizik dhe juridik, më qëllim të verifikimit të deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.
5. Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje pajtohen që të zgjerojnë fushën e bashkëpunimit edhe përmes formave të tjera si:
 - a) Trajnimet e përbashkëta;
 - b) Pjesëmarrja në Seminare të përbashkëta;
6. Parimet e ruajtjes së konfidencialitetit të informatave dhe dokumenteve të kësaj natyre, do të zbatohet me përpikëri në mes të palëve nënshkruese. Informatat lidhur me identitetin e tatimpaguesit nuk mund të behën publike dhe do te përdoren vetëm për qëllime të përcaktuara në pikën katër të MIM"e jo për qëllime tjera.
7. Bashkëpunimi do të realizohet në mes të zyrtarëve përkatës kontaktues si dhe në pajtueshmëri të plotë me zotimet që dalin nga kjo Marrëveshje.
8. Në rast të paraqitjes së konfliktit të kompetencës, rastet e paraqitura do të raportohen te Menaxhmenti i institucioneve palë të kësaj Marrëveshje, të cilët japin mendimin përfundimtar për çështjen e ngritur.
9. Për çdo ndryshim në ligjet e cekura më lartë dhe në ligjet tjera të kësaj lëmie, palët do të rinegociojnë mundësinë e përfshirjes së ndryshimeve, në afat prej 30 ditësh në këtë Marrëveshje.
10. Asnjë nga veprimet e cekura më lart, që adresojnë format e bashkëpunimit ndërinstytucional nuk guxojnë të përdoren për dëmtimin e proceseve hetimore apo formave tjera të publikimeve që mund ta diskreditojnë secilën palë nënshkruese të kësaj Marrëveshje.
11. Kjo Marrëveshje shfuqizohet, me paralajmërim me shkrim nga njëra palë në afat prej 30 ditësh, ndërsa mospajtimet rreth shkëljes së ndonjë dispozite të kësaj marrëveshje zgjidhen përmes bisedimeve dhe mirëbesimit të ndërsjellët.

12. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj nga Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit dhe Drejtori Gjeneral i Administratës Tatimore të Kosovës dhe vlen për periudhën kohore prej 1 viti, me mundësi vazhdimi sipas marrëveshjes me shkrim të palëve.

13. Marrëveshja është nënshkruar në 4 (katër) kopje identike origjinale, nga 2 (dy) kopje për secilën palë nënshkruese.

Nënshkruar në Prishtinë, me datë: 11 / 6 / 2010

Agjencia kundër Korrupsionit

Drejtori




Hasan Preteni



Administrata Tatimore e Kosovës

Drejtori Gjeneral



Behxhet Haliti